



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 1401/4 Prot.

Vlorë më, 22 . 04 .2026

VENDIM

Nr. 13, datë 22/04/2026

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKT-PROPOZIMEVE TË FAKULTETIT TË EKONOMISË,
NË KUADËR TË PROGRAMIT TË KËRKIM-ZHVILLIMIT (PKZHUV),
TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORË, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 93, 95, pika 1, 2, 3, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, pika 3, dhe kreut IX të Statutit të UV-së; nenit 8, pika 6, 7 dhe 8, të Rregullores për Projektet të Kërkim-Zhvillimit të financuara nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; vendimit të Senatit Akademik të UV-së nr. 16, datë 06.05.2021, si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, me nr. 1012/1 prot., datë 15.04.2026; Rektorati, në mbledhjen e datës 22.04.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë projekt-propozimet me financim nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (PKZHUV), të paraqitur nga Fakulteti i Ekonomisë, si më poshtë:
 - Zhvillimi I një Modeli të Guidës Turistike Inteligjente për Promovimin Digjital të Destinacioneve dhe Turizmit të Qëndrueshëm në Jug të Shqipërisë
 - STUDIMI ALUMNI-BIZNES-STUDENT: Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet të diplomuarve, bizneseve dhe studentëve
 - Analiza e ofertës gastronomike në Bashkinë e Vlorës dhe roli I saj në zhillimin e turizmit lokal.
 - Financat e Gjelbra dhe Investimet e Qëndrueshme në Strukturat Akomoduese në Qarkun e Vlorës.
 - Vlerësimi I hendekut të kompetencave midis formimit akademik përmes kurrikulave dhe nevojave të tregut të punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Ndhmës Akademike në UV.
3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Fakultetit të Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof.Dr. Aurela Saliq

